

37.768

REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E RRETHIT GJYQSOR TIRANE

NR. 37768 VENDIMIT

V E N D I M
PER REGJSTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Sot ne date 17.03.2007, unë QRIJ gjyqtare e Gjykates se Rrethit Gjyqsor Tirane , pasi shqyrtova kerkese~~n~~ e kerkuesit Ilir Cepani dhe dokumentat per regjistrimin person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar te emertuar "Chocoworld " sh.p.k ;


K O N S T A T O V A :

Se me dt.06.02.2007 eshte krijuar shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e emertuar " Chocoworld " sh.p.k ; me seli ne Kashar Tirane ; me kohezgjatje te pakufizuar ; me kapital themeltar 100.000 leke ; me ortake : Ilir Cepani me pjesmarrje 40% te kapitalit , Stefan Pinguli me pjesmarrje 30% te kapitalit , Kujtim Kellezi me pjesmarrje 15% te kapitalit dhe Mihal Panteqi me pjesmarrje 15% te kapitalit themeltar ; me administrator Ilir Cepani ; me objekt veprimtarie : " Prodhim cokollata, bomboneri, vafer, biskota, industria e akulloreve, embelsira te gjitha llojeve ose te produkteve te ndryshme te industrise ushqimore ; Tregtim me shumice e pakice ne tregun vendas dhe per eksport te artikujve te mesiperme; Tregtim te linjave teknologjike per industrine ushqimore ; Ofrim e sherbimeve qe lidhen me objektin e veprimtarise se shoqerise " .

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet te pranohet.

P E R K E T O A R E S Y E :

Ne baze te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligjit nr.7667 date 28.1.1993 "Per regjistrin tregtar".




VENDOSA :

Regjistrimin person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar te emertuar " Chocoworld " sh.p.k ; me seli ne adresen Kashar Tirane ; me kohezgjatje te pakufizuar ; me kapital themeltar 100.000 leke ; me ortake : Ilir Cepani me pjesmarrje 40% te kapitalit, Stefan Pinguli me pjesmarrje 30% te kapitalit , Kujtim Kellezi me pjesmarrje 15% te kapitalit dhe Mihal Panteqi me pjesmarrje 15% te kapitalit themeltar ; me administrator Ilir Cepani ; me objekt veprimtarie : "Prodhim cokollata, bomboneri, vafer, biskota, industria e akulloreve, embelsira te gjitha llojeve ose te produkteve te ndryshme ne industrine ushqimore ; Tregtim me shumice e pakice ne tregun vendas dhe per eksport te artikujve te mesiperme; Tregtim te linjave teknologjike per industrine ushqimore ; Ofrim e sherbimeve qe lidhen me objektin e veprimtarise se shoqerise ".

Kunder vendimit lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane.

GJYQTARE



**KONTRATE THEMELIMI
SHOQERIA ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"Chocoworld " Shpk**



Neni 1

Ne ortaket :

1. **Ilir Njazi Çepani**, i biri i Njaziut, lindur me 27.04.1953 banues ne qytetin e Tiranës Rruga Siri Kodra nr.48
2. **Stefan Dhimiter Pinguli**, lindur me 27.12.1953 banues ne qytetin e Tiranës Rruga Isa Buletini nr.185.
3. **Kujtim Mehmet Kellezi**, lindur me 04.04.1953, banues ne Tirane rruga Kavajes, pallatet e reja prane N.SH.R.A.K-ut.
4. **Mihal Aristir Panteqi**, datlindjes 1953, banues ne Tirane, rruga Zhan D'Ark, pallatet e firmes Edil

Neni 2

Selia e shoqerise do te jete ne Tirane, Komuna Kashar, fshati Mezez ne autostraden Tirane – Durres kilometri 7. Me vendim te asamblese se ortakeve mund te hapen agjensi, filiale ose dege brenda dhe jashte territorit te Shqiperise.

Neni 3

Kohezgjatja e veprimtarise te shoqerise do te jete pa afat dhe do te filloi nga momenti i regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesore Tirane

Neni 4

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj :

- a) prodhim cokollata, bomboneri, vafer, biskota, industria akulloreve si dhe prodhime te embelsirave te gjitha llojeve, ose te produkteve te ndryshme ne industrine e lehte ushqimore.
- b) tregtimi i mallrave te çdo lloji me shumice e pakice te artikujve te siperm per tregun brenda vendit dhe eksport, per lendet e para ne industrine ushqimore si dhe linjave teknologjike te ndryshme qe lidhen me fushat e sipërme.
- c) Ofrimi i sherbimeve te cdo lloji qe lidhen me objektin e veprimtarise te kesaj shoqerie.

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke i formuar ne mase te plote nga kontributi i ortakeve si me poshte :



- **Ilir Cepani** ka derdhur 40.000 leke dhe ka ne pronesi 40 perqind te kapitalit themeltar te shoqerise.
- **Stefan Pinguli** ka derdhur 30.000 leke dhe ka ne pronesi 30 perqind te kapitalit themeltar te shoqerise.
- **Kujtim Kellezi** ka derdhur 15.000 leke dhe ka ne pronesi 15 perqind te kapitalit themeltar te shoqerise.
- **Mihal Panteqi** ka derdhur 15.000 leke dhe ka ne pronesi 15 perqind te kapitalit themeltar te shoqerise

Mbi bazen e kontributit te kapitalit themeltar te shoqerise do te ndahet edhe fitimi i realizuar gjate veprimtarise se shoqerise tregtare.

Neni 6

Shitja e pjeseve te kapitalit themeltar nga ortakët do te behet ne perputhje me statutin. Kur njeri nga ortakët kerkon te shese pjesen e vet te kapitalit themeltar, eshte i detyruar t'ia shese ortakeve te tjere. Kur ortakët nuk paraqesin interes ky ortak ka te drejte t'ia shese personave te trete jashte shoqerise, ne perputhje me procedurat e statutit te saj. Cmimi shitjes te pjeses se kapitalit themeltar te ortakut ofruet si dhe menytrat e pageses behen sipas afateve qe cakton asambleja ortakeve.

Shitja e pjeses se kapitalit themeltar tek persona fizike ose juridike jashte shoqerise, eshte e pandashme dhe pronari ose bashkepronaret e kesaj pjese te kapitalit themeltar ne cilesine e ortakut te ri caktojne perfaqesuesin e tyre per ti perfaqesuar ne mbledhjen e ortakeve. Ky rregull vlen edhe ne rastet e transferimit te pjeses te kapitalit themeltar nga ortakut tek trashegimtarët e tij. Te gjitha keto veprime behen me akte noteriale.

Neni 7

Administratori i Shoqerise, do te jete zoti Ilir Cepani, i biri i Njaziut dhe Bukuries, datelindjes 27.04.1953, lindur dhe banues ne Tirane rruga Siri Kodra nr.48, i cili mban pergjegjesi te plote para ligjit per gjithcka qe lidhet me administrimin e shoqerise.

Emerimi dhe shkarkimi i tij behet nga mbledhja e ortakeve me 51 perqind te pjeseve te kapitalit themeltar qe zoterojne ortakët.

Mbledhja e ortakeve merr te gjitha vendimet qe kane lidhje me drejtimin e shoqerise tregtare ne perputhje me nenet e klauzolat e percaktuara ne statutin e vet, si dhe cakton te gjitha rregullat per funksionet e administratorit.

Neni 8

Administrimi i llogarive bankare te shoqerise behet nga administratori ne perputhje me dispozitat ligjore si dhe rregullat qe vendos mbledhja e ortakeve.

Neni 9

Ne perputhje me rregullat e vendosura nga mbledhja e ortakeve, administratori nenshkruan kontratat per punesimin e personelit ne kete shoqeri tregtare, si dhe ka te drejte per shkelje te rregullave, te largoje nga puna punonjesit ne fjale sipas dispozitave ligjore.

Neni 10

Veprimtaria e shoqerise "Chocoworld" shpk pervec kontrates se themelimit rregullohet ne perputhje me statutin e saj. Kontrata e themelimit perpilohet ne 4 kopje dhe do te administrohet sipas dispozitave ligjore.

ORTAKET

ILIR CEPANI

ILIR CEPANI

Ilir Cepani

Kujtim Kellezi

KUJTIM KELLEZI

Kellezi

STEFAN PINGULLI

Stefan Pingulli

Mihal Panteqi

MIHAL PANTEQI

Mihal Panteqi

Tirane, me ____ .02.2007

STATUTI
SHOQERIA ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“CHOCOWORLD” SHPK



1. Forma e shoqerise tregtare dhe baza ligjore

“Chocoworld” SHPK eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar dhe baza ligjore e tij eshte Kodi Civil i Republikes Shqiperise dhe Ligji Nr. 7638, dt. 19.11.1992 “Mbi shoqerite tregtare”.

2. Emri, emblema dhe vula zyrtare

2.1 Emri i plote i *Shoqerise Tregtare* do te jete “Chocoworld” SHPK.

2.2 *Shoqeria Tregtare* do te kete vulen e saj zyrtare dhe emblemen.

2.3 Te gjithë dokumentet qe do te dalin nga kjo *Shoqeri Tregtare* ne marredhenie me palet e treta, do te kene emrin e plote te saj, vulen e regjistruar zyrtare dhe sipas perdorimit emerit e administratorit te pergjitheshem ose te ortakeve me fuqine e tyre perfaqesuese.

3. Viti financiar

Viti financiar i *Shoqerise Tregtare* do te jete viti kalendarik.

4. Vendodhja dhe selia

4.1 Vendndodhja e *Shoqerise Tregtare* do te jete ne territorin e Republikes se Shqiperise.

4.2 Selia e *Shoqerise Tregtare* do te jete ne Tirane, Komuna Kashar, fshati Mezez Autostrada Tirane – Durres kilometri 7. Shoqeria mund te ndryshoje seline me vendim te asamblese se ortakeve.

5. Kohezgjatja ose afati i veprimtarise

Kohezgjatja e *Shoqerise Tregtare* ose afati i veprimtarise se vet, do te jete per nje periudhe te pacaktuar kohe.

5.1 Shoqeria Tregtare mund te kryejë çdo transaksion te çdo lloji mase qe do te jete e nevojshme ose e dobishme per arritjen, zgjerimin ose modernizimin e biznesit te saj, perfshi edhe blerjen e pasurive te paluajtshme, shitblerjen e aksioneve brenda dhe jashte kompanise, te hapjes te degeve ose filialeve ne Republiken e Shqiperise dhe jashte saj, si dhe per realizimin e interesave ne sipermarret e tjera te biznesit.

6. Objekti i veprimtarise se Shoqerise Tregtare

6.1 Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete :


- a) prodhim cokollata, bomboneri, vafer, biskota, industria akulloreve si dhe prodhime te embelsirave te gjitha llojeve, ose produkteve te ndryshme ne industrine e lehte ushqimore.
- b) Tregtimi i mallrave te cdo lloji me shumice e pakice te artikujve te siper per tregun brenda vendit dhe eksport, per lendet e para ne industrine ushqimore si dhe linjave teknologjike te ndryshme qe lidhen me fushat e mesiperme.
- c) ofrimi i sherbimeve te çdo lloji qe lidhen me objektin e veprimtarise te kesaj shoqerie tregtare;

7. Kapitali i Themeltar

7.1 Kapitali i themeltar i *Shoqerise Tregtare* do te jete ne total 100.000 leke dhe i depozituar ne nje nga bankat vendase.

7.2 Ortaket e *Shoqerise Tregtare* do te jene:

- a) Ilir Njazi Çepani, i biri i Njaziut, lindur me 27.04.1953 banues ne qytetin e Tiranes Rruga Siri Kodra nr.48, me 40% te kapitalit themeltar, duke perfaqesuar 40 kuota te barabarte nje vlere 40.000 leke ;
- b) Stefan Dhimiter Pinguli, lindur me 27.12.1953 banues ne qytetin e Tiranes Rruga Isa Buletini nr.185, me 30% te kapitalit themeltar, duke perfaqesuar 30 kuota te barabarte me nje vlere totale prej 30.000 leke.



- c) Kujtim Mehmet Kellezi, lindur me 04.04.1953, banues ne Tirane rruga Kavajes, pallatet e reja prane N.SH.R.A.K-ut, me 15% te kapitalit themeltar, duke perfaqesuar 15 kuota te barabarte me nje vlere totale prej 15.000 leke
- d) Mihal Aristir Panteqi, lindur me 1953, banues ne Tirane rruga Zhan D'Ark, pallatet e firmes Edil, me 15% te kapitalit themeltar, duke perfaqesuar 15 kuota te barabarte me nje vlere totale prej 15.000 leke.


8. Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar

8.1 Pjeset e kapitalit themeltar ne Shoqerine Tregtare do te jene te transferueshme ne perputhje me nenin 8. Per qellime e kesaj *Klauzole* nje "transferte" ka kuptimin e çdo forme te kalimit te pronesise mbi pjeset e kapitalit themeltar ne *Shoqerine Tregtare* nga ortaku perkates ne çfaredo menyre ose çfaredo forme qofte (duke perfshire pakufizim nje kalim pronesie te pjeseshem ose te plote nepermjet nje shitjeje, apo bashkimi kapitalesh).

8.2 Çdo transferte (me perjashtim te trashëgimise) behet nga mbledhja e ortakeve dhe vendimi merret ne perputhje me nen-klauzolat e meposhtme:

8.2.1 Ne rastin kur nje ortak deshiron te transferoje pjesen e kapitalit themeltar te tij ne *kete Shoqeri Tregtare*, ky ortak ("**Ortaku Transferues**") duhet te njoftoje te gjithë ortaket e tjere te *Shoqerise Tregtare* si dhe administratorin e saj ku te theksoje synimin e tij per te transferuar permes shitjes pjeset e kapitalit themeltar te vet, kuoten e ketij kapitali, bazen ligjore per nje transferte te tille, si dhe termat tregtare te transfertes. Njoftimi do te jete nje kerkese me shkrim e *Ortakut Transferues* per miratimin e transfertes tek ortaket e tjere te *Shoqerise Tregtare*.

8.2.2 Pas marrjes se *Njoftimit*, administratori i kesaj Shoqerie Tregtare organizon nje takim te ortakeve brenda 15 diteve. Ne kete takim ortaket diskutojne kuotat e kapitalit themeltar qe vihen ne shitje si dhe termat qe lidhen me cmimin, menyren dhe afatet e likujdimit te pagesave, etj. Rradha e te drejtes te parablerjes nga ortaket e Shoqerise Tregtare eshte sipas rradhes te kapitaleve qe zoterojne ne kete Shoqeri. Ne rastin kur mbledhja e pare e ortakeve nuk merr dot vendim per te vendosur kush nga ortaket do te jete blerese i kuotave te ofruara per shitje, zhvillohet nje takim i dyte me te njejten axhende nga administratori brenda tre muajve. Rregullat e





caktuara per takimin e pare te ortakeve ne *Klauzolen 8.2.2* do te jene te vlefshme edhe per mbledhjen e dyte per te percaktuar se kush nga ortakët do te jete bleresi i pjeseve te kapitalit themeltar te ofruar per shitje. Ne rast se ne mbledhjen e dyte nuk arrihet blerja e pjeseve te kapitalit themeltar te ofruar, per shkaqe te ndryshme si cmimi, menytrat e pagese, etj., atehere ortakut transferues pas kalimit te afatit tre mujor per marrjen e vendimit nga mbledhja e ortakeve, i lind e drejta ti shese pjeset e kapitalit themeltar te ofruara per shitje, jashte kesaj Shoqerie Tregtare personave fizike ose juridike vetem ne perputhje me kete statut.

8.2.3 Shitjblerja e pjeseve te kapitalit themeltar te sejcilit ortak behet me akt – noterial.

9. Ne rastin e shitjes te pjeseve te kapitalit themeltar jashte Shoqerise, cdo ortak transferues qe ben kete transferte duhet te siguroje qe cdo bleres pasardhes i tij, te jete dakort me te gjitha pikat e *Statutit* dhe te jete pale me ortakët e tjere te kesaj Shoqerie per realizimin e detyrimeve qe rrjedhin nga marreveshjet.

10. Ndarja e pjeseve te kapitalit themeltar

10.1 Asnje pjese e kapitalit themeltar qe ofrohet per shitje, nuk do te jete i ndashem, duke respektuar aktin e themelimit si dhe statutin e kesaj Shoqerie Tregtare.

10.2 Ne rastin kur nje pjese e kapitalit themeltar me ane te shitjes ose trashegimise, eshte ne bashke-pronesi te me shume se nje personi, bashke-pronaret e pjeseve te ketij kapitali themeltar jane te detyruar te perfaqesohen ne kete Shoqeri Tregtare dhe para ortakeve te tjere, nga njeri prej tyre si perfaqesues i caktuar nga bashke-pronaret.

10.3 Pas percaktimit te nje bashke-pronesie, te gjithë bashke-pronaret duhet me njoftim me shkrim te gjithë sebashku te informojne *Shoqerine Tregtare* dhe cdo ortak tjetër te saj, si dhe te depozitojne prane kesaj Shoqerie te gjitha dokumentat qe vertetojne pronesine ose bashkepronesine mbi keto pjese te kapitalit themeltar qe zoterojne, duke zbatuar te gjitha percaktimet e pikes 10.2. duke emeruar perfaqesuesin e vet.

11. Te drejtat dhe detyrimet ne lidhje me pjeset e kapitalit themeltar ne pronesi ose bashkepronesi.

Çdo pjese e kapitalit themeltar do te kete te njejtat te drejta dhe detyrime, sipas aktit te themelimit dhe statutit te kesaj Shoqerie Tregtare. Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar nga njeri ortak tek nje ose me shume persona, shoqerohet me te njejtat te drejta dhe detyrime per ortaket e ardheshem.

12. Administratori

Administrator i shoqerise eshte emeruar zoti Ilir Cepani, i biri i Njaziut dhe Bukuries, i datlindjes 27.04.1953, lindur dhe banues ne Tirane rruga Siri Kodra nr.48, i cili mban te gjitha pergjegjesite ligjore per drejtimin e kompanise.

Emerimi dhe shkarkimi i administratorit nga mbledhja e ortakeve te kesaj Shoqerie Tregtare dhe vendimi duhet te merret me 51 perqind te pjeseve te kapitalit themeltar qe zoterojne ortaket.

Pavec kesaj administratori shkarkohet nga gjykata per shkelje te ligjit me kerkese te cdonjerit prej ortakeve.


12.1 Shoqeria Tregtare do te menaxhohet nga administratori sipas legjislacionit ne fuqi, *Statutit*, urdhrave dhe çdo vendimi te marre nga mbledhja e ortakeve.

12.2 Perfaqesimi i Shoqerise Tregtare nga nje administrator do te lejohet vetem me vendim te mbledhjes te ortakeve. Administratori nuk mund te delegoje pushtetin e tij te perfaqesimit tek nje person tjeter, pa miratimin paraprak me shkrim nga mbledhja e ortakeve.

12.3 Administratori nuk mund te angazhohet ne biznese te tjera ne rolin e administratorit dhe nuk mund te marrin asnje funksion ne institucione te tjera ekonomike ose politike, Shoqeri Tregtare ose grupe interesi pa miratimin paraprak te mbledhjes se ortakeve.

12.4 Vetem mbledhja e ortakeve ka te drejte te nxjerre vendime dhe urdhera me fuqi detyruese per tu zbatuar nga administratori, te cdo lloj natyre qe lidhen me veprimtarine e Shoqerise Tregtare.

12.5 Transaksionet e meposhtme nga administratori duhet te kene me pare nga mbledhja e ortakeve miratimin me shkrim me 2/3 ose 66.6 perqind e kapitalit fillestar te ortakeve :



- a) Çdo rregull te brendshem te nxjerre nga administratori per aktivitetet e biznesit te *kesaj Shoqerie Tregtare* si dhe percaktimin e detyrave;
- b) Cdo kontrate qe lidhet me blerjen e materjaleve ose lendeve te para, perdorimin e mjeteve ose makinerive ne interes te Shoqerise Tregtare.
- c) Perdorimi i pasurive te patundshme dhe ndertesave, duke perfshire edhe percaktimin e normave te fitimit.
- d) Dhenia ose marrja e huave ose kredive nga *Shoqeria Tregtare ose cdo kontrate sherbimi* ne marrdhenie me persona te trete fizik ose juridik;
- e) Hapja ose mbyllja e ndonje filiali, dege apo zyre te Shoqerise Tregtare;
- f) Hapjen dhe mbylljen e linjave te biznesit dhe llojeve te produkteve;
- g) Percaktimin e parimeve te pergjithshme te politikave te biznesit;
- h) Buxhetin gjashtemujor dhe vjetor te Shoqerise Tregtare;
- i) Administrimi i llogarive bankare te *kesaj Shoqerie Tregtare* ne funksion se biznesit te *ndermarrjes*.
- k) Dhenien e prokurave per marrjen e nje ose disa avokateve ne interes te Shoqerise Tregtare;


12.6 Zvogelimi i kapitalit te shoqerise tregtare deri ne kufirin qe lejon ligji behet vetem me 3/4 ose 75 perqind te votave qe zoterojne ortakët.

12.7 Per te gjitha ceshtjet e sipërme Administratori raporton me shkrim ne mbledhjet e ortakëve.

13. Mbledhja e Ortakëve

13.1 Çdo mbledhje e ortakëve do te organizohet ne perputhje me *Ligjin per Shoqerite Tregtare* dhe ligje te tjera te aplikueshme. *Njoftimi* behet me shkrim dhe dergohet 15 dite para dates se takimit dhe duhet te kete te cituar edhe daten, oren dhe vendin e takimit, axhenden si dhe dokumentat perkatese do te jene te bashkangjitura ketij takimi. Pas marrjes se axhendes, administratori pergatit te gjithë projekt-dokumentat qe do te miratohen nga mbledhja ortakëve.

13.2 Takimet e ortakëve do te mbahen ne seline e *Shoqerise Tregtare* ose ne nje nga filialet ose deget ne Republiken e Shqiperise ose ne çdo vend tjeter brenda territorit te Shqiperise te specifikuar ne nje vendim te vecante nga ortakët.



13.3 Çdo takim ortakeve do të kryesohet nga ortaku me përqindjen me të madhe të pjesëve të kapitalit themeltar në *Shoqerine Tregtare*.

13.4 Një ortak mund të përfaqësohet në takim nga një ortak tjetër ose nga bashkeshortja ose një avokat. Ky i fundit duhet të paraqesë prokuren të bërë nga ortaku para noterit dhe duhet të behet i njohur ortakeve të tjera para takimit të mbledhjes së ortakeve. Origjinali i këtij dokumenti do të mbahet në këtë *Shoqeri Tregtare*.

13.5 Në lidhje me kuorumen të mbledhjes së ortakeve, do të aplikohen nënklauzolat e mëposhtme:

13.6.1 Çdo pjesë e kapitalit themeltar të *Shoqerise Tregtare* i jep të drejtën ortakut përkatës të një vote në mbledhjen e ortakeve. Çdo ortak, qoftë direkt qoftë nëpërmjet përfaqësuesit të tij ka vetëm të drejtën e votes për të gjithë aksionet e tij në këtë *Shoqeri Tregtare*.


13.6.2 Me përjashtim të vendimeve që merren me 3/4 ose 75 përqind të votave që zoterojnë ortakët, çdo vendim tjetër merret vetëm nga mbledhja e ortakeve, që kanë të paktën 66.6 përqind ose 2/3 të të gjithë pjesëve të kapitalit themeltar në këtë *Shoqeri Tregtare* dhe që janë të pranishëm ose janë të përfaqësuar sipas pikës 13.5.

13.6.3 Çdo pikë e përmendur në axhenden e mbledhjes të ortakeve do të jetë e ndarë nga pikat e tjera dhe vendimet merren vec e vec për secilën pikë me kuorumin përkatës, të shprehura në nënklauzolat e këtij statuti.

13.7 Kryesuesi i takimit organizon mbajtjen e protokollit të mbledhjes të ortakeve. Ky protokoll nënshkruhet nga kryesuesi dhe të gjithë aksionerët e pranishëm në takim ose përfaqësuesit e tyre. Një origjinal i protokollit do të mbahet në *Shoqerine Tregtare* dhe çdo ortak mund të kërkojë të shohë në këtë *Shoqeri Tregtare* protokollin e mbajtur me pare.

13.8 Asnjëri nga ortakët nuk ka të drejtë të blejë aksione në shoqeri anonime të tjera, ose pjesë të kapitalit themeltar në shoqeri me përgjegjësi të kufizuar që zhvillojnë aktivitet të njëjta me *Shoqerine Tregtare* "Chocoworld" shpk ku janë ortakë.

14. Kontabiliteti dhe auditori



14.1 Per kontabilitetin e *Shoqerise Tregtare* do te jete pergjegjes administratori dhe do te veproje sipas ligjeve ne fuqi.

14.2 Audituesi i *Shoqerise Tregtare* caktohet nga mbledhja e ortakeve. Audituesi duhet te jete i licensuar dhe i kualifikuar si dhe i kryen funksionet e veta sipas ligjeve ne fuqi dhe ne perputhje me kontraten e nenshkruar me Shoqerine Tregtare.

15. Detyrimi i Konfidencialitetit (ruajtja e te dhenave)

15.1 Ortaket e *Shoqerise Tregtare*, administratoret, audituesit si dhe personat e tjere te punesuar nga *Shoqeria Tregtare* dhe konsulente ose keshilltaret e saj, jane te detyruar te mbajne konfidencialitetin e çdo informacioni ne lidhje me *Shoqerine Tregtare* dhe aktivitetin e saj, informacion te cilin e marrin gjate ose per shkak te funksionit te tyre ose per interesat e kesaj Shoqerie Tregtare. Detyrimi i konfidencialitetit gjithashtu do te aplikohet edhe pas largimit ose mbarimit te funksionit perkates ne kete *Shoqeri Tregtare* te pakten deri ne pese vjet nga dita mbasi nderpret marredheniet e punes me kete Shoqeri.

15.2 Mbledhja e ortakeve percakton natyren e materjaleve, te dhenat si dhe procedurat e detajuara ne lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit te per shkak te detyres, i cili eshte i detyrueshem per çdo person te permendur ne *Klauzolen 15.1*.

16. Dokumentacioni kontabel dhe libri i shoqerise


Shoqeria eshte e detyruar te mbaje dokumentacionin kontabel. Ne librin e shoqerise shenohen emeri i plote i shoqerise, ortaket, kapitali themeltar, perqindja ortakeve si dhe vendimet qe merr mbledhja e ortakeve.

17. Bilanci financiar

Bilanci financiar mbyllet me 31 dhjetor te cdo viti. Llogarite vjetore, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabel (audituesi) miratohen nga mbledhja e ortakeve.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

18. Njoftimet



Çdo njoftim ose komunikim behet me shkrim dhe me poste rekomande si dhe duke pasqyruar adresen, emblemen dhe siglen perkatese te Shoqerise Tregtare.

19. Ndryshimet ne statut

Ndryshimet e neneve ne statut behen te pavlefeshme vetem ne rast se bien ne kundershtim me ligjet e reja ose kur vendos me shumice mbledhja e ortakeve me 3/4 ose 75 perqind te votave qe zoterojne ortaket, e cila ndryshimet perkatese ne statut i depoziton ne regjistrin tregtar sipas dispozitave ligjore.

20. Shperndarja e shoqerise tregtare

Shperndarja e shoqerise mund te behet me vendim te mbledhjes te ortakeve ose me vendim te gjykates, duke u caktuar likuidatorët dhe procedurat e likuidimit ne perputhje dispozitat ligjore.

21. Zgjidhja e mosmarreshjeve

Te gjitha mosmarreshjet qe mund te lindin gjate ekzistences se shoqerise do te zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqesore Tirane.

ORTAKET

ILIR CEPANI

ILIR CEPANI

Ilir Cepani

Kustim Kellezi

KUSTIM KELLEZI

Kellezi

STEFAN PINGULI

Stefan Pinguli



MIHAL PANTEQI

Mihal Panteqi



Tirane, me _____ .02.2007

zj: E. Bejo
dt. 27.02.2007

27 FEB. 2007

37768

KERKESE

SHKRUARËS : - ILIR CEPANI , i biri i Njaziut , lindur me 27.04.1953 ne Tirane dhe banues ne "Iri Kodra" nr.48 Tirane, administrator i shoqerise "Chocoworld" shpk .

KERKUESI : Kerkoj regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Chocoworld " shpk .

Legjislacioni : Ligji 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligji 7667 date 19.11.1992 "Per regjistrin tregtar".

GJYKATES RRETHIT GJYQSOR

TIRANE

Kerkuesi jam administrator i shoqerise te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar te "Chocoworld" shpk , me seli ne Kashaqer Tirane ; me kohezgjatje te pakufizuar ; me kapital themeltar 100.000 leke ; me ortak : Ilir Cepani me pjesmarrje 40% te kapitalit dhe Stefan Pinguli me pjesmarrje 50% te kapitalit , Kujtim Kellezi me pjesmarrje 10% te kapitalit dhe Mihal Panteqi me pjesmarrje 15% te kapitalit themeltar ; me objekt te primarise : "Prodhim cokollata, bomboneri, vafer, shokolade, mbelsira te gjitha llojeve si dhe prodhim te lendeve te para te ketyre artikujve; te shumice e pakice ne tregun vendas dhe per eksport te artikujve te mesiperm; te linjave teknologjike per industrine ushqimore dhe te lehte si dhe asistence teknologjike dhe teknologjike per prodhimin e produkteve te mesiperm .
Kerkuesi kerkon regjistrimin si person juridik te shoqerise "Chocoworld" Shpk ne regjistrin tregtar kates se rrethit Gjyqesor Tirane .

KERKUESI

ILIR CEPANI

Ilir Cepani


REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NOTERE MARJETA DH. BRISKU
NR. 237 REP.
NR. 62 KOL.

VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Tirane, sot me dt. 06.02.2007 (dymije e shtate) perpara meje noteres Marjeta Brisku , e regjistruar ne Dhomen e Notereve Tirane , me adrese Bulevardi "Gj.Fishta" u paraqit personalisht :

ILIR CEPANI , i biri i Njaziut, lindur me 27.04.1953 ne Tirane dhe banues ne Tirane , me pasaporte nr.Z0774564 , madhor , me zotesi te plote juridike per te vepruar , administrator i shoqerise " Chocoworld" Shpk , i cili kerkoi vertetimin e nenshkrimit te kerkeses per regjistrim person juridik te shoqerise " Chocoworld" Shpk bashkelidhur , per te cilin deklaroi se e ka hartuar me vullnetin e tij te lire dhe te plote .

Sa me siper nenshkroi rregullisht perpara meje dhe une noterja ne baze te n.39 te ligjit "Per Noterine" e vertetoj .



NOTERE
MARJETA DH.BRISKU

Marjeta Dh. Brisku

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NOTERE MARJETA DH.BRISKU

Tirane, më 09.02.2007

VERTETIM

Me ane te cilit vertetoj se prane kesaj zyre eshte depozituar shuma 100.000 Leke , e cila perfaqeson vleren e kapitalit themeltar per krijimin e shoqerise "Chocoworld" Shpk .

Ky vertetim leshohet ne baze te n.40 te Ligjit n.7638 dt.19.11.1992 "Per shoqerite Tregtare" per efekt te regjistrimit te shoqerise "Chocoworld" Shpk ne regjistrin tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane .

NOTERE

MARJETA DH. BRISKU



Marjeta Dh. Brisku

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NOTERE MARJETA DH. BRISKU
NR. 254 REP.
NR. 69 KOL.

VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Tirane, sot me dt. 09.02.2007 (dymije e shtate) perpara meje noteres
Marjeta Brisku , e regjistruar ne Dhomen e Notereve Tirane , me adrese
Bulevardi "Gj.Fishta" u paraqit personalisht :

ILIR CEPANI , i biri i Njaziut, lindur me 27.04.1953 ne Tirane dhe banues
ne Rruga "Siri Kodra" nr.48 Tirane , me pasaporte nr.Z0774564 ;

STEFAN PINGULI , i biri i Dhimitrit , lindur me 27.12.1953 ne Tirane dhe
banues ne Tirane rruga "Isa Boletini" nr.185 Tirane, me pasaporte
nr.Z0036097 ;

KUJTIM KELLEZI, i biri i Mehmetit, lindur me 04.04.1953 ne Tirane dhe
banues ne Rruga "Kavajes" , pallatet e reja prane NSHRAK Tirane, me
pasaporte nr.Z0037422 ;

MIHAL PANTEQI , i biri i Aristirit, lindur me 25.02.1953 ne Tirane dhe
banues ne Rruga "Zhan D'Ark" pallatet Edil-Al Tirane, me pasaporte
nr.Z1107687 ;

Te mesipermit jane madhore , me zotesi te plote juridike per te vepruar ,
ortake te shoqerise "Chocoworld" Shpk , te cilet kerkuan vertetimin e
nenshkrimt te Kontrates se Themelimit te shoqerise " Chocoworld" Shpk
bashkelidhur , per te cilin deklaruan se e kane hartuar me vullnetin e
tyre te lire dhe te plote .

Sa me siper nenshkruan rregullisht perpara meje dhe une noterja ne
baze te n.39 te ligjit "Per Noterine" e vertetoj .

NOTERE
MARJETA DH.BRISKU



Handwritten signature of Marjeta Dh. Brisku

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NOTERE MARJETA DH. BRISKU
NR. 255 REP.
NR. 70 KOL.

VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Tirane, sot me dt. 09.02.2007 (dymije e shtate) perpara meje noteres Marjeta Brisku , e regjistruar ne Dhomen e Notereve Tirane , me adrese Bulevardi "Gj.Fishta" u paraqiten personalisht :

ILIR CEPANI , i biri i Njaziut, lindur me 27.04.1953 ne Tirane dhe banues ne Rruga "Siri Kodra" nr.48 Tirane , me pasaporte nr.Z0774564 ;

STEFAN PINGULI , i biri i Dhimitrit , lindur me 27.12.1953 ne Tirane dhe banues ne Tirane rruga "Isa Boletini" nr.185 Tirane, me pasaporte nr.Z0036097 ;

KUJTIM KELLEZI, i biri i Mehmetit, lindur me 04.04.1953 ne Tirane dhe banues ne Rruga "Kavajes" , pallatet e reja prane NSHRAK Tirane, me pasaporte nr.Z0037422 ;

MIHAL PANTEQI , i biri i Aristirit, lindur me 25.02.1953 ne Tirane dhe banues ne Rruga "Zhan D'Ark" pallatet Edil-Al Tirane, me pasaporte nr.Z1107687 ;

Te mesipermit jane madhore , me zotesi te plote juridike per te vepruar , ortake te shoqerise "Chocoworld" Shpk , te cilet kerkuan vertetimin e nenshkrimet te Statutit te shoqerise " Chocoworld" Shpk bashkelidhur , per te cilin deklaruan se e kane hartuar me vullnetin e tyre te lire dhe te plote .

Sa me siper nenshkruan rregullisht perpara meje dhe une noterja ne baze te n.39 te ligjit "Per Noterine" e vertetoj .

NOTERE
MARJETA DH.BRISKU



Marjeta Dh. Brisku

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E SHENDETESISE
Drejtoria Higjenës, Epidemiologjisë dhe
Inspektoriatit Sanitar Shtetëror

Tiranë, 15-02-2007

Nr. 362 Prot.

Nr. 20 Rregjistri

Nr. 1240 Mandati

LEJE për PERSON FIZIK/JURIDIK Nr. 20

Bazuar në Ligjin Nr. 7643, datë 02.12.1992 "Për Inspektoriatin Sanitar Shtetëror"
dhe Deklaratës personale të lëshuar nga Subjekti:

ILIR CEPANI, i përfaqësuar nga: LIMJE PRODHIMI
ÇOKOLLATE me vend ndodhje në: KASHAR
SHPK ÇOKOWORLD i jepet:

Leje për Prodhimin, Tregëtimin, Importimin dhe/ ose Eksportimin e Produkteve
Ushqimore, ushtrim profesioni , etj.

Mbështetur në Ligjin e sipërshtënëuar, neni 12, Personi fizik ose juridik, para fillimit
të aktivitetit për të cilën është dhënë Leja, është i detyruar të paraqitet në Organin e
Inspektoriatit Sanitar Shtetëror për t'u pajisur me **Leje higjiene - sanitare vjetore** për
Objektin në përputhje me destinacionin . Mos zbatimi i kësaj detyre përbën shkelje
ligjore.

Leja hartohet në dy kopje, një i jepet Subjektit kërkues për t'u paraqitur në Gjykatën
e Rrethit dhe tjetra arkivohet në organin e Inspektoriatit Sanitar Shtetëror të rrethit.

KRYEINSPEKTORI SANITAR SHTETEROR I RRETHIT

Dr. MANUSHI THANASI

Inspektori Sanitar Shtetëror

NAJIM RAMA

Almir

